



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:096225

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697453

KPPP.nr.1642/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit T.C. Ziraat Bankasi A. S- Dega në Kosovë, me NUI:810839748, me seli në Prishtinë, Rr."Ukshin Hoti" nr.13, kundër debitorëve 1.) "Gashi Komerc" Sh.P.K. me NRB:811034173, me seli në Suharekë Rr."..." pn. 2.) G.G. me adresë banimi në Suharekë Rr."..." pn., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Nazmi Mustafi avokat nga Prizreni Rr."Mbreti Pirro" nr.1, 3.) M.G. me adresë në Suharekë Rr."..." pn., dhe 3). S.G. me adresë banimi në Suharekë Rr."..." pn., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.n.188/22 të datës 14.04.2022, të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha, me seli të zyrës në Prizren, jashtë seancës, me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorëve 1.) "Gashi Komerc" Sh.P.K. me NRB:811034173 dhe 2.) G.G., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.188/22 të datës 14.04.2022, të Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha, me seli të zyrës në Prizren.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.188/22 i datës 14.04.2022, i Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha, me seli të zyrës në Prizren.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Rushit Hoxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Marrëveshjes Kryesore nr..RM0219/2 e datës 14.04.2019, Marrëveshjes së kredisë me nr.K0219/20 sipas Marrëveshjes Kryesore nr.RM0219/2 e datës 17.04.2019, Marrëveshjes për Mbitërheqje me numër K0219/21.1 e datës 29.04.2020, Konfirmimit të Regjistrimit R-20190417-232 të datës 17.04.2019, Konfirmimit të Regjistrimit R-20200429-103 e datës

29.04.2020, Kontrata për Themelimin e Hipotekës me numër LRP.2345/2019 e datës 15.04.2019, Aktvendimi për Regjistrimin e Hipotekës me numër 11-463-24991-2019, duke detyruar debitorët t'ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 53,257.45 €, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbarues me qëllim të përmbylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorit, si dhe të detyrohen debitorët që të kompensojnë shpenzimet procedurale aq sa ato do jenë të llogaritura nga zyra përmbarimore sipas udhëzimit Administrativ nr.06/2014 Udhëzim për tarifën për shpërblimet dhe kompensimin për përmbaruesit privat.

Kundër urdhrit përmbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar i autorizuari i debitorit të parë dhe dytë me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, në rastin konkret me qenë se çështja është për detyrim periodik dhe afat për kthimin e kredisë është 60 muaj, pra dokumenti përmbarimor nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për përmbarim dhe nuk përmban tipare të përmbarueshmërisë. Ka shtuar kreditori e ka dëmtuar debitorin e parë ku ka transferuar mjetet në vlerë prej 20,000.00 euro në llogarinë e kompanisë në bankën “Raiffeisen”, me të cilat mjete debitori ka bërë pagesën e kredisë për afat shtatë mujor, të cilat mjete veç të harxhuara për pagesën e kredisë i ka tërhequr dhe rikthyer në formë retroaktive, për të vepruar kreditori sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me dispozitat e KPPRK-së. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të refuzoj në tërësi propozimin dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se i kundërshton pretendimet e paraqitura në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se në prapësim nuk është paraqitur as edhe një argument i vetëm ligjor dhe bazuar në të dhënat në prapësim shihet qartë se qëllimi i debitorit është që të zvarrisë ekzekutimin e dokumentit të përmbarueshëm. Ka shtuar se urdhri përmbarimor është qartazi titull ekzekutiv dhe ka tipare të përmbarueshmërisë dhe se kreditori i ka mundësuar debitorit kohë për shlyerjen e borxhit por borxhi ka mbetur i pa shlyer. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit, urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi dhe të detyrohet ti paguaj shpenzimet e procedurës .

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbartues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen Kryesore nr..RM0219/2 e datës 14.04.2019, Marrëveshjen e kredisë me nr.K0219/20 sipas Marrëveshjes Kryesore nr.RM0219/2 e datës 17.04.2019, Marrëveshjen për Mbitërheqje me numër K0219/21.1 e datës 29.04.2020, Kontratës për Themelimin e Hipotekës me numër LRP.2345/2019 e datës 15.04.2019, gjeti se të njëjtat janë paraqitur në kopje të vërtetuara pranë organit kompetent, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Aktvendimi për Regjistrimin e Hipotekës me numër 11-463-24991-2019, Konfirmimi i Regjistrimit të pengut R-20190417-232 të datës 17.04.2019, dhe Konfirmimi i Regjistrimit të pengut R-20200429-103 të datës 29.04.2020 dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i kanë

plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorëve të paraqitura në prapësim e ka dëmtuar debitorin e parë ku ka transferuar mjetet në vlerë prej 20,000.00 euro në llogarinë e kompanisë në bankën “Raiffeisen”, me të cilat mjete debitori ka bërë pagesën e kredisë për afat shtatë mujor, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësime tjera të paraqitura, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohe vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1642/2022, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.